



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 06 Prot.

Lezhë, më 10 .08 . 2020

VENDIM

Nr. 10 , datë 07.08.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR SHFRYTËZIM TË MATERIALEVE INERTE, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RUBIK DHE MILOT , BASHKIA MIRDITË DHE KURBIN,
PËR SUBJEKTIN "SALILLARI" SH.P.K

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 12, pika 1 neni 44, pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar , V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”, dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat , Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I :

1. Miratimin e lejes “ Për shfrytëzim të materialeve inerte” subjektit “SALILLARI ” SH.P.K. sipas kushteve të mëposhtme:

Shfrytëzimi i materialeve inerte të bëhet me shtresa uniforme dhe jo me gropa me thellësi të ndryshme;

- ✓ Gjatë shfrytëzimit të materialit zhavorr të lumit Fan dhe Mat , të zbatohen me korrektësi kushtet e vendosura në studim për koordinatat dhe kuotat e shfrytëzimit.
- ✓ Shfrytëzimi i zhavorreve të bëhet më shtresa uniforme dhe jo me gropa me thellësi të ndryshme.
- ✓ Në fillim të zbatimit të projektit të shfrytëzimit duhet të vendoset një reper me koordinata të përcaktuara për monitorimin e thellësisë së shfrytëzimit.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meçi

